



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-3307/1 të datës 26.06.2019, me pretendime për keq menaxhim dhe funksionim të pakujdesshëm në NP /// – ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim në rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-3307/1 të datës 26.06.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat prej pes (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 26.06.2019 është dorëzuar denoncim me pretendime për keq menaxhim dhe punë të pakujdesshme në NP /// – /// dhe është formuar lënda me numër 12-3307/1 të datës 26.06.2019.

Në denoncim parashtruesi pa përmendur veprime konkrete, tregon më shumë parregullsi në punën e dhe organizimin e NP /// – ///: pjesëmarrje jo të rregullt të punëtorëve në vendin e punës, marrje të parave drejt për drejt, shfrytëzim jo të rregullt të makinave zyrtare dhe angazhim jo të duhur të shoferit.

Në raport shprehet dyshimi edhe për asgjësim të pakujdesshëm të mjeteve në llogari të NP /// – ///, për inkasimin e parregullt të shërbimeve komunale, për moszbatim të procedurave për prokurim publik dhe për prerje të paligjshme të pemëve.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në lëndë, KSHPK-ja konstatoi se pretendimet e paraqitura nuk janë korrupsion në përputhje me definicionin e përcaktuar në ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gjithashtu denoncimi përmban pretendime të përgjithshme dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme që të njëjtat të shfrytëzohen, Nga këtu, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprime kompetent për rastin e lëndës.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përpiloi: A.R.M.

Miratoi: G.T., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

